

PYETJE TESTI NGA LENDA TEKNOLOGJIA INFORMATIKE

VITI I II-te

1. Cka eshte baza e te dhenave?

Bazë e të dhënave është çfarëdo grumbulli informatash të organizuara në grup. Informatat duhet të jenë të organizuara ashtu që lehtë mund të ju qasemi.

2. Cka jane Tabelat (ang. Tables)?

Ky objekt definon strukturën e një baze në Access. Tabelat përmbajnë numër të madh të dhënash në rreshta dhe në kolona. Këto të dhëna mund të futen, ndryshohen, ruhen dhe të kthehen.

3. Cka jane Pyetesoret (ang. Query)?

Është mënyrë për kërkimin e informacioneve në tabelë. Kur ekzekutojmë një pyetësor, të dhënat paraqiten në të quajturin Recordset. Pastaj këto të dhëna mund të ndryshohen ose të shtypen (printohen).

4. Cka jane Format (ang. Form)?

Lejon futjen e të dhënave, shikimin si dhe ndryshimin e tyre. Forma mund të shfrytëzohet si alternativë për paraqitjen e të dhënave në rreshta dhe në kolona.

5. Cka jane Raportet (ang. Report)?

Është dizajn për të dhënat që do të shtypen (printohen). Raportet përfshijnë raportet nga baza e të dhënave. Në raporte poashtu mund të kryhen llogaritje matematikore.

6. Cka eshte Çelsi Primar (ang. Primary Key)?

Access-i punon në mënyrë më efikase nëse vejmë çelësin primar në tabelë. Çelësi primar është një fushë ose një grup i cili në mënyrë unike identifikon çdo të dhënë. Më së lehti është që si çelës primar të vehet fusha me tipin e të dhënave AutoNumber.

7. Cka eshte Text?

Text është një tip i të dhënave që përmban çdo kombinim të shkronjave, numrave, shenjave të pikësimit dhe hapësirës. Ku si mundësi e parazgjedhur është 50 karakter ndërsa maksimumi është 255 karakter.

8. Cka eshte Number?

Fusha Number mund të përmbajë vetëm karakter numerik, presjen (për mijëshe), pikën (për pikë decimale) dhe minus (vijë, për shenjë të numrave negativë). Number shfrytëzohet vetëm kur kemi të bëjmë me kalkulime me vlerat e fushave.

9. Cka eshte Date/Time?

Date/Time përmbanë datën dhe/ose kohën. Access-i automatikisht vlerëson futjen e datës duke u siguruar se është valide. Fusha Date/Time është e përdorshme për kalkulimin e datës dhe kohës.

10. Cka eshte AutoNumber?

Tipi i të dhënave AutoNumber automatikisht cakton numrin unik (prej 1) secilës të dhënë. Nuk mundemi të fusim vlerë në një fushë ku më parë Access-i ka caktuar vlerën.

11. Cka eshte Hyperlink?

Fusha Hyperlink shfrytëzohet për lidhjen me ndonjë faqe në internet, document të Word-it në intranet ose edhe formë në bazë të të dhënave.